



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2021:106732

Datë: 31.08.2023

Numri i dokumentit: 04634937

**C-III-23-0198**

*Parashtruesi*

**Autoriteti i Likuidimit për NSH “Plantacioni” Ferizaj,  
Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.**

**Kundër**

*E paditura*

**Komuna e Ferizajt, Ferizaj**

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 31 gusht 2023, lëshon këtë

**A K T V E N D I M**

- 1. Padia për kthim në gjendje të mëparshme dhe kompensimin e dëmit material dhe kërkesa për masë të sigurimit konsiderohen të tërhequra.**
- 2. Parashtruesi i bart shpenzimet gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 16 qershor 2023, Gjykata Themelore në Ferizaj, nëpërmjet aktit përcjellës ka dërguar lëndën me të gjitha shkresat e saj për vendosje të mëtutjeshme. Me 20 qershor 2023, lënda u regjistrua në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje Dhoma e Posaçme) nën numrin AC-I-23-0352-A0001.

Me 27 korrik 2023, Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme me aktvendimin AC-I-23-0352, aprovoi ankesën e të paditurës si të bazuar duke anuluar aktvendimet e Gjykatës Themelore në Ferizaj nr. 2021:106732 (C.nr.404/21) datë 1 qershor 2021 dhe aktvendimin nr. 2019:256878

(C.nr. 2019:25689) datë 19 shtator 2022 dhe kërkesën për caktimin e masës së sigurisë e ktheu për rivendosje.

Me 01 gusht 2023, gjykata lëshoi urdhër për parashtruesin ku ndër të tjera kërkoi nga i njëjti pagesën e taksave gjyqësore për padi dhe për kërkesë për masë të sigurimit, duke e njoftuar se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, padia dhe kërkesa për masë të sigurimit do të konsiderohen të tërhequra. Me 07 gusht 2023, urdhri u pranua nga parashtruesi, i cili me parashtrësën e datës 18 gusht 2023 u përgjigj ndaj urdhrit të gjykatës duke mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës për masë të sigurimit, mirëpo nuk pagoi taksat gjyqësore.

Për detaje të tjera referimi të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor**

Padia dhe kërkesa për masë të sigurimit konsiderohen të tërhequra.

Neni 76.3 i Ligjit nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, parasheh:

*Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Parashtruesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që lëndës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Në vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

*Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 01 gusht 2023, gjykata përmes urdhrit kërkoi nga parashtruesi, që ndër të tjera të bëjë pagesën e taksave gjyqësore, duke e njoftuar se padia dhe kërkesa për masë të sigurimit do të konsiderohen të tërhequra nëse ai nuk e paguan taksat gjyqësore.

Parashtruesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksave gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Parashtruesi ka për obligim t'i paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Urdhri ishte pranuar nga parashtruesi me 7 gusht 2023, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi.

Nga kjo gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka interes për çështjen e tij juridike dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore padia dhe kërkesa për masë të sigurimit konsiderohen të tërhequra.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), parashtruesi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Shkelzen Sylaj, gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare